

VENDIM
Nr. 102, datë 16.4.2021

**MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT TË
SHOQËRISË OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SHA, PËR DISA
NDRYSHIME NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË BALANCIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 19, 62, 98, 99 dhe 100, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të neneve 15, 19 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregulator Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; të nenit 3, pika 3.3, të “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 16.4.2021, mbasi shqyrtoi propozimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., për disa ndryshime në “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”,

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 1384 prot., datë 25.2.2021, ka paraqitur raportin e vlerësimit lidhur me zbatimin e “Rregullave të mekanizmit balancues, për muajin janar 2021”, ku ndër të tjera propozon disa ndryshime në rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike dhe anekset përkatëse, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020.

- Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, parashikojnë që rregullat mund të ndryshohen bazuar në shkaqe të argumentuara nga ana e OST sh.a. Propozimet e përcjella përmes shkresës nr. 1384 prot., datë 25.2.2021, si ato që lidhen me formën e dokumentit dhe ato që lidhen me përmbajtjen e tij, nuk janë shoqëruar me argumentimet përkatëse ku të evidentohet nevoja për kryerjen e ndryshimit të kërkuar.

- Propozimet e përcjella nuk përmbushin detyrimet që rrjedhin nga pika 3.3, e nenit 3 (miratimi dhe rishikimi), të “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”. OST sh.a., në cilësinë e propozuesit të ndryshimeve të këtij dokumenti, duhet të krijonte një komitet përgjegjës për ndryshimin e rregullave, i cili inicion ndryshimin e tyre. Ky ndryshim i propozuar, në vijim, paraqitet zyrtarisht nga OST për miratim të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1384/2 prot., datë 18.3.2021, në përgjigje të shkresës së ERE-s nr. 397/1 prot., datë 9.3.2021, OST sh.a. ka bërë me dije se, citojmë: “Nuk ka hapur procedurë konsultative me palët e interesit dhe Sekretariatit e Energjisë”, sa i përket propozimeve për ndryshim në “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 89, datë 31.3.2021, “Mbi propozimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Për rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike nga data 1 prill 2021”, është vendosur tashmë nisja e efekteve financiare të rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, “Mbi miratimin e rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, për palët përgjegjëse për balancim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e propozimit të shoqërisë OST sh.a., për disa ndryshime në “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë OST sh.a. mbi vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti